

VENDIM
Nr. 204, datë 4.12.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË
DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, nenit 29, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 127/3 prot., datë 2.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Drejtoritë Teknike kanë draftuar “Rregulloren për depozitimin e gazit natyror”, për t’u siguruar palëve të interesuara të industrisë së gazit, aktin rregullator që përcakton kriteret për ushtrimin e aktivitetit nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

- Ky dokument do të sigurojë një pasqyrë më të qartë të modaliteteve të ushtrimit të këtij aktiviteti, veçanërisht për vend-depozitimin e gazit në depozitimet kripore (Diapiret e dumresë), në vendburimet e shteruara të naftës (vendburimet: Cakran–Mollaj, Ballsh–Hekal, Visokë, Patos, Gorisht–Kocul, Marinëz), dhe vendburimet e gazit (Divjakë, Frakull, Povelçë, Ballaj–Kryevdh, Panaja, Finiq–Kranë), në shtresat ujore (*Aquifaire*) atje ku mund të identifikohen, në Republikën e Shqipërisë.

- Kjo rregullore paraqet kriteret që ERE planifikon të përdorë kur merret parasysh regjimi më i përshtatshëm i aksesit të palëve të treta ose përjashtimi për depozitimin e gazit në Shqipëri në të ardhmen.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror”.

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti